

AKTI I THEMELIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
INTERNATIONAL MARKET SOLUTIONS

Sot, me date 29.05.2022 në Rruga Zonja Curre Nd.31, H.4, Ap.21 Njësia bashkiake nr. 2 Tiranë Shqipëri., është prezent presoni fizikë, Z. Fabjan Mehmeti, qytetar shqiptar, lindur më 25.03.1978 në Çorovodë Skrapar, dhe rezidentë në Rruga Pandi Dardha Pallati 34 shkalla 2 Kt.3 Laprak Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal, kartë identiteti nr. 035437404 dhe numër personal H80325186Q, e lëshuar më datë 24.12.2019 dhe e vlefshme deri më datë 23.12.2029 Personi si më sipër i cilësuar dhe i përfaqësuar ka deklaruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, themelimin e një shoqërie në bazë të ligjit n. 9901 del 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe si pasojë edhe redaktimin e Aktit të Themelimit, të sajë aktiviteti i së cilës do të rregullohet nga statuti i sajë, pjesë plotësuese e këtij akti themelimi të aprovuar dhe rregullishtë të nënshkruar nga ana e ortakëve si më posht vijon:

NENI 1

Themelohet shoqëria e emëruar **INTERNATIONAL MARKET SOLUTIONS Sh.p.k.**, më poshtë e quajtur edhe shoqëria.

Shoqëria është objekt i ligjit shqiptar, ndërsa filialet qe mund te krijohen do te jene objekt i ligjit te vendit ku ato do te kenë selinë. Shoqëria do te ushtroj aktivitetin e saj ne baze te këtij akti themelimi dhe ne baze te Statutit te saj te miratuar nga ortakët.

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqërisë është në Rruga Zonja Çurre, Nd.31, H.4, Ap.22, 1010, Njësia Administrative Nr.2 Tiranë Shqipëri.

NENI 3

OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqëria ka për objekt – në limitet dhe në respektim të normave her pas here në fuqi – cfardolloji aktiviteti konsulence, asistence dhe ofrimi shërbimi ndërmarrjeve duke ju referuar në veçanti ndërmarrjeve tregtare, industriale, zejtare dhe turistike. Shoqëria ka si qëllim të veprorë për të zhvilluar këto aktivitete për llogari të vetë ose të të tretëve me seli në Shqipëri ose në cdo vend tjetër të lidhur me Republikën e Shqipërisë në respektim të normave në fuqi.

Aktivitetet e zhvilluara mund të jenë, vetëm si shembull por jo në mënyrë ezauruese:

- Konsulencë dhe asistencë për manaxhimin e ndërmarrjeve, redaktimin e biznes planeve, kontrollin e manaxhimit, kualiteti, kërkim i financimeve kombëtare dhe BE, kontabiliteti online, hetime të tregut krijimin dhe manaxhimin e rrjeteve të shitjeve, rrjete të shpërndarjes dhe përfaqësimit me apo pa mandat shërbimi, shërbime residence dhe sekretarisë, formimit të personelit edhe për sigurinë në punë, dhe formimin profesional për personat që duhet të punojnë nëpër ndërmarrje të ndryshme.



- Aktivitetin e marketingut të ndërmarrjeve, zhvillimin e strategjive të marketingut, shërbime në lidhje me marketingun online, pozicionimin e produkteve, branding, asistencë në tregëtim, marketing në sektorin e telekomunikimit dhe të shërbimeve të telefonisë, publiciteti fizik dhe online.
- Informatikë: zhvillimin e software për aplikime web dhe për funksionimin dhe kontrollin në distancë të makinave të ndërlukuara, edhe nëpërmjet përdorjes të softëare-ve për përdorim industrial; zhvillimin e sistemeve informatike për industrinë; projektimin dhe furnizimin e sistemeve të ndërlukuara hw/sw me çelsat në dorë; përpunimin e të dhënave online për ndërmarrjet por edhe për administratën publike.
- Shërbimet e import-export dhe të promovimit tregtar të shitblerjes në Shqipëri dhe në vendet jashtë e finalizuar për eksport, shërbime në lidhje me mbështetjen operative në aktivitetin tregtar të huaj edhe nëpërmjet mbështetjes të zyrave të dedikuara, shërbime të përkthimeve dhe të kontratualistikës, shërbime llogjistike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona fizikë ose juridikë ose me çdo shoqëri tjetër që ka të njëjtin objekt veprimtarie brenda ose jashtë vendit. Objekti i këtij aktiviteti do të jetë çdo lloj aktiviteti i ngjashëm me sa më sipër, i cili do të konsiderohet i vlefshëm nga politikat tregtare të shoqërisë dhe që nuk është në kundërshtim me legjislacionin aktual për marrëdhëniet e tregtisë së lirë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të fitojë gjithashtu interesa dhe aksione në shoqëri ose ndërmarrje të tjera të çdo natyre që kanë një objekt të ngjashëm, ose të lidhur me të vetën; mund të lëshojë gjithashtu garanci në përgjithësi, duke përfshirë edhe ato reale, për sa kohë që ato lidhen drejtpërdrejt me qëllimin e shoqërisë. Të gjitha këto aktivitete mund të kryhen në mënyrë jo ekskluzive, jo në mardhënie me publikun si dhe në përputhje me ligjet në fuqi për aktivitetet e rezervuara.

Shoqëria mund të kryej kërkime dhe studime në fushat e aktivitetit të shoqërisë dhe mund të tregtoj dhe të marrë përfaqësime të produkteve në lidhje me fushat e aktivitetit të shoqërisë.

NENI 4

Për zhvillimin e aktivitetit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me persona fizik dhe juridik, të vendit ose të huaj.

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqëria, ka një kohëzgjatje pa afat dhe do të marrë personalitet në momentin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) Tiranë.

NENI 6

KAPITALI THEMELTARE I SHQOERISE

Kapitali themeltarë i shoqërisë është 10.000 (dhjetëmijë) Lekë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë që i përket ortakut si më poshtë të emëruar:

Ortaku themelues: Z. Fabjan Mehmeti, qytetar shqiptar, lindur më 25.03.1978 në Çorovodë Skrapar, dhe rezidentë në Rruga Pandi Dardha Pallati 34 shkalla 2 Kt.3 Laprak Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal, kartë identiteti nr. 035437404 dhe numër

personal H80325186Q, e lëshuar më datë 24.12.2019 dhe e vlefshme deri më datë 23.12.2029 i cili do të zotërojë 1 (një) kuotë me një vlerë totale prej Lekë 10.000 (dhjetëmijë) e cila do të përbëj 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltarë të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zvogëlohet ose mund të rritet dhe është plotësisht i likuiduar dhe i nënshkruar.

NENI 7

Ortakët e shoqërisë marrin përgjegjësin për të rritur volumin e punëve në shoqëri, të respektojnë detyrimet për sa i përket ruajtjes të sekretit që janë të lidhura me tipin e aktivitetit tregtar që do të zhvillohet nga shoqëria dhe të mos dëmtojnë interesat e vet shoqërisë, duke u angazhuar që të mos themelojnë në Shqipëri aktivitete konkurruese me objektin e shoqërisë.

NENI 8

DREJTIMI I SHOQERISE

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Fabjan Mehmeti, qytetar shqiptar, lindur më 25.03.1978 në Corovod Skrapar, dhe rezidentë në Rruga Pandi Dardha Pallati 34 shkalla 2 Kt.3 Laprak Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal, kartë identiteti nr. 035437404 dhe numër personal H80325186Q, e lëshuar më datë 24.12.2019 dhe e vlefshme deri më datë 23.12.2029 i cili emërohet për 5 (pes) vjet duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtën për tu rizgjedhur, nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos që ta shkarkoj atë nga kjo detyrë para përfundimit të këtij mandati, ose në rastin e paraqitjes me përpara të dorëheqjes nga ana e administratorit sipas procedurave të parashikuara nga ligji.

Të gjithë personat ortak ose jo ortak që ushtrojnë detyrën e administratorit do të aplikojnë politikat tregtare të vendosura nga ana e asamblesë së përgjithshme në bazë të ligjit shqiptar.

NENI 9

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakëve të saj. Asambleja e përgjithshme vendos në bazë të ligjit shpërndarjen ose investimin e fitimeve duke vendosur dhe mënyrat.

NENI 10

Asambleja e përgjithshme emëron ose revokon Administratorët që janë në detyrë dhe mund të emërojnë dhe administratore të tjerë duke i shtuar atyre ekzistues dhe me kompetenca të përcaktuara në bazë të ligjit.

Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e përcaktuara nga ligji, për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, do të përfaqësojë shoqërinë në raportet me të tretet me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti i jep ortakëve shprehimisht.

Kompetencat e administratorit janë vendosur në Statutin e Shoqërisë, në bazë të ligjit. Për çështje të një rëndësie të veçantë, administratori konsultohet me ortakët dhe aplikon vendimet e marra nga asambleja e ortakëve, të marra me shumicën e parashikuar nga ligji.

NENI 11

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve do të zgjidhen në bazë të nenit 30 të Statutit të Shoqërisë.



NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa te përgjithshme, e realizuar sipas dispozitave ligjore ne fuqi dhe mund te ketë edhe një marke te veten.


NENI 13

Shoqëria deklarohet e themeluar ne aplikim te plote te normave te Statutit dhe ne baze te normave ligjore shqiptare dhe ne veçanti me ligjin n. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Akti i themelimit hartohet ne 3 (tre) kopje te nënshkruara rregullisht nga ortaket.

**INTERNATIONAL MARKET SOLUTIONS Sh.p.k.,
ORTAKU**

Z. Fabjan Mehmeti

A handwritten signature in blue ink, reading "Fabjan Mehmeti". The signature is written in a cursive style with a long horizontal stroke at the end.A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized version of the name "Fabjan Mehmeti".